



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
HASAN PRISHTINA

Lënda: **MEDIAT DHE POLITIKA**

Semestri dimëror 2016/17, lëndë zgjedhore

Ligjëruese: Remzie Shahini-Hoxhaj, PhD

e-mail: remzie.hoxhaj@uni-pr.edu

Asistent: Dren Gerguri

e-mail: dren.gerguri@uni-pr.edu

Koha: e martë, 9-10:30, sala 51

Përmbajtja e lëndës:

Politika në Kosovë ka ndryshuar në formë drastike këtë dekadën e fundit. Një arsye për këtë është edhe ndikimi i mediave si pushteti i katërt. Pothuajse të gjitha informatat që sot kemi për vendimet politike, i dim nga mediat. Në media shohim se cili politikan është më simpatik më karizmatik dhe cili do të mbes në politikë. Si bëhet raportimi dhe kush i përzgjedh temat? Kur formulohen objektivisht? Si funksionon marrja e një vendimi? A mund tu besojmë rezultateve? Kjo lëndë është e dizajnuar në atë mënyrë që të ju njoh me relacionin mes mediave dhe politikës, aspektin teorik dhe rregulativave të mediave në Kosovë si dhe efekteve sociale dhe politike të tyre.

Qëllimet e lëndës:

Qëllimi i lëndës është të ju pajisë me njohuri themelore teorike dhe praktike të studiuesve të ndryshëm për rolin e mediave në politikë dhe anasjelltas. Në këtë lëndë ju do të njiheni me lidhjet mes mediave, opinionit publik dhe politikës në vend dhe lidhjen e tyre me botë. Si funksionojnë mediat në demokraci dhe çka duhet të presim nga to. Cili është roli i mediave në njohurit politike dhe cila është fuqia e pjesëmarrjes qytetare. Çka është framing, praming dhe agenda settings. Si po e ndikon interneti sot vendimmarrjen politike në vend dhe në botë.

Metodologjia e punës: Ligjërata do të ndahen në pjesën e ligjërimit, referateve të shkurta dhe pjesë interaktive të shembujve të ndryshëm. Studentet do të ftohen hulumtojnë, të zhvillojnë mendimin kritik për ambientin politik në të cilin jetojnë dhe të ngrisin njohurit e tyre akademike përmes pjesëmarrjes aktive. Ligjëratat do ju dedikohen temave që do ti lexoni ndërsa diskutimet do të jenë ato të cilat koincetojnë nga hulumtimet e juaja. Prandaj përveq literaturës obligative për detyrë keni ta lexoni: Kohën Ditore, ti shihni lajmet qëndrore në transmetuesin publik RTK dhe përcjellin agjensionin e lajmeve KosovaPress. Poashtu duhet ti shihni filmat: The Truth (2015), Jackie (2016), Grace of Monaco (2016), Frost/Nixon (2008), The King's Speech (2010) etj.

Vlerësimi:

20% Ushtrimet

40% Prezantimet per temat e percaktuara

40% Provimi perfundimtar

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min	15	2.5
Kollokfiume,seminare	8	1	8
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	10	1	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiiz,provim final)	3	2	6
Projektet,prezentimet ,etj	30 min	1	0.5
Totali			117 orë= 5 ECTS

LIGJËRATAT:

1. Prezantimi i lëndës
2. Objektiviteti i mediave, animet dhe raportimi politik
3. Ndikimi i mediave- agenda setting
4. Regullimi i mediave dhe qeveria
5. Komunikimi politik - sjellja politike e shoqërive masive
6. Politika dhe gazetaria senzacionale
7. Infotainment dhe rëndësia e tij
8. Kampanjat politike në kohën e mediave të reja
9. Mediat dhe politika ndërkomtare
10. E ardhmja e mediave dhe demokracisë
11. Situatat e krizave

Literatura obligative:

Denqiu, Jean-Marie (2000): Hyrje në Shkencat Politike. 4/ Shkenca Sociale. Tiranë: UET Press

Heywood, Andrew (2008): Politika. Tiranë: Botimet Dudaj

Holtz – Bacha, Christina (Hrsg.)(2008): Frauen, Politik und Medien. Wiesbaden. VS Verlag

für Sozialwissenschaften

Kuhn, Raymond dhe Neveu, Erik (2002): Gazetaria politike. Sfidat të reja, praktika të reja. Tiranë: Insituti Shqiptar i Medias.

Marcinkowski, Frank (Hrsg)(2014): Framing als politischer Prozess. Beiträge zum Deutungskampf in der politischen Kommunikation. Baden-Baden. Nomos Verlagsgesellschaft

McNair, Brain (2009): Hyrje në komunikim politik. Tiranë: UET press 2009

McCombs, Maxwell (2006): Setting the Agenda. The mass media and the public opinion. Cambridge. Polity press

Princi nga Niccolo Machiaveli

Literatura shitesë:

Craig, Geoffrey (2004): The Media, Politics and Public. Allen & Unwin

Iyengar, Shanto (2011): Media Politics: A Citizen's Guide. 2nd edition. W.W. Norton & Company.

Feste, Karin A (2011): America responds to terrorism. Conflict resolutions strategies of Clinton, Bush and Obama. Pallgrave Maximillian

LifeBennett, W. Lance, Regina G. Lawrence and Steven Livingston (2007): When the Press Fails

Mekuli, Gëzim (2006): Mediat dhe politika. Oslo: Mekuli Press